



Memorandum për bashkëpunim

ndërmjet

Agjencionit për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional (MAPAS) nga Republika e Maqedonisë

dhe

Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) nga Republika e Kosovës

Agjensioni për mbikëqyrje të Sigurimeve pensionale plotësisht të Financuara (në tekstin e mëposhtëm: MAPAS), nga njëra anë

dhe

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëposhtëm: BQK) nga ana tjetër,

- duke pasur parasysh rëndësinë e vendosjes së bashkëpunimit, shkëmbimin e njohurive dhe përvojave, të cilat kanë të bëjnë me reformat e sistemit pensional dhe rregullimin dhe mbikëqyrjen e fondeve pensionale si dhe ;
- gatishmëria për të kontribuar në zhvillimin dhe përfundimin e sektorit pensional, arritën marrëveshje dhe u pajtuan si në vijim:

Neni 1

Palët do të shkëmbejnë përvoja të arritura në fushën e fillimit të reformës pensionale, punës së fondeve pensionale, mekanizmat e mbikëqyrjes së fondeve pensionale dhe rregulloret e miratuara dhe masat ligjore.

Neni 2

1. Për qëllimet e këtij Memorandumi, bashkëpunimi teknik ndërmjet palëve përfshin:
 - a) shkëmbim të dokumenteve, përfshirë vendime, udhëzime dhe publikime, si dhe çfarëdo informacione të tjera në lidhje me aktivitetet e palëve, të vendeve të palëve kontraktuese;
 - b) ndihmë bilaterale me qëllim shkëmbimin e përvojave nga interesi i përbashkët;
 - c) bashkëpunim në fushën e edukimit, hulumtimit, trajnimeve dhe proceseve zhvillimoreme interesi të përbashkët, dhe
 - d) mënyra tjera të bashkëpunimit me pajtimin e palëve.

BQK Zyra e Zyqever për mbikq. financ. Kancel. Zm. qever. za financ. nadz. Office of Vice gover for financ. superv.	
Data e Primit Datum Primit Received on	N 26.11.12 212/1979
F. Dmuzuari Imeni Name	N. K Veprimi: Razmat: Action:

2. Memorandumi nuk ndryshon as nuk zëvendëson ndonjë ligj, rregullore ose kërkesa të cilat janë në fuqi, ose të cilat zbatohen në Republikën e Maqedonisë ose në Republikën e Kosovës. Ky Memorandum nuk krijon të drejta direkte ose indirekte të zbatueshme. Palët pajtohen se në disa raste ndihma mund të refuzohen përshkak të mbrojtjes së interesit publik.

Neni 3

Kur vendosin të bashkëpunojnë nëndonjë nga mënyrate theksuara në nenin 2 paragrafi 1, nën paragrafët b), c) dhe d), palët do të përgatisin plan të aktiviteteve. Në plan do të përfshihen forma dhe vëllimi i bashkëpunimit, shkëmbimi i personelit, lartësia dhe shpërndarja e shpenzimeve dhe çështje tjera të lidhura me bashkëpunimin.

Neni 4

Kërkesat për informacione ose ndihmë të bëra në përputhje me këtë Memorandum do të jenë në formë të shkruar por në raste emergjente kërkesa mund të bëhet edhe gojarisht e cilakërkesë duhet të konfirmohet me shkrim brenda dhjetë ditësh kalendarike. Të gjitha komunikimet ndërmjet palëve duhet të realizohen përmes kontakt personave të theksuara në Aneksin 1, përveç nëse janë pajtuar ndryshe.

Neni 5

1. Të gjitha informacionet e shkëmbyera sipas këtij Memorandumi, palët nënshkruese do t'i trajtojnë si konfidenciale dhe do t'i shfrytëzojnë posaçërisht për qëllime të mbikqyrjes.
2. Kusht i nevojshëm për bashkëpunim të suksesshëm ndërmjet MAPAS dhe BQK është se gjithë personat e autorizuar të cilët gjatë aktiviteteve do të pranojnë informacione konfidenciale nga pala tjetër duhet të respektojnë obligimin për ruajtjen e sekretit afarist. Në asnjë rast, palët nuk do të zbulojë informacione konfidenciale të marra në përputhje me këtë Memorandum dhe nuk do t'i japë këto informacione personave të tretë pa pëlqim paraprak të palës tjetër.

Neni 6

1. Të punësuarit e caktuar nga secila palë që të ndërmarrin aktivitete të cilat rrjedhin nga bashkëpunimi sipas këtij Memorandumi do të veprojnë në përputhje me udhëzimet dhe nën drejtimin e menaxherëve të institucioneve në të cilat punojnë, në mënyrë që nga ai bashkëpunim nuk do të lindin marrëdhënie pune me palën tjetër.
2. Për të punësuarit, të cilët janë të deleguar nga njëra palë te pala tjetër do të jenë të detyruar të respektojnë dispozitat e ligjit në fuqi të shtetit pranues dhe udhëzimet, statutet si dhe aktet tjera të institucionit pranues. Të punësuarit e lartpërmendurnuk lejohen të ndërmarrin aktivitete të tjera përveç të ato të dakorduaraapo të pranojnë kompensim shtesë, para se për këtë të kenë pëlqim me shkrim nga punëdhënësi.

Neni 7

Çdo mosmarrëveshje që do të lind nga interpretimi ose implementimi i këtij Memorandumi ose projektet të vendosura në bazë të këtij Memorandumi do zgjidhen në mënyrë miqësore nga palët nënshkruese.

Neni 8

1. Memorandumi do të jetë në fuqi derisa nuk e ndërpritet nga njëra palë nënshkruese duke njoftuar me shkrim palëntjetër 60 dite para datës së propozuar për ndërprerjen.
2. Amandamenti e këtij Memorandumi do të kenë efekt ligjor vetëm nëse palët pajtohen, në formë të shkruar dhe theksojnë datën e hyrjes në fuqi. Ndërprerja e këtij Memorandumi nuk do ta pengojë përfundimin e projektit të filluar para ndërprerjes së tij, përveç nëse palët vendosin ndryshe.

Neni 9

Ky Memorandum është shkruar në gjuhën maqedone, shqipe dhe angleze. Të gjitha tre versionet gjuhësore do të konsiderohen njëjloj të vlefshme.

Në rast të mospërputhjes në interpretimin e dispozitave të këtij Memorandumi që dalin nga diferenca në gjuhë, atëherë mbizotrohet versioni në gjuhën angleze.

Memorandumi do të jetë i plotëfuqishëm nga data e nënshkrimit të saj nga ana e e Agjencisë për Mbikëqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional të Republikës së Maqedonisë dhe Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës.

Nënshkruar në dy kopje në _____.

Më datë _____.

Për
Agjencioni për mbikëqyrje të
financimit kapital të sigurimit
pensional (MAPAS)
Mentor Jakupi
Zëvendës drejtor



Për
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Nexhat Kryeziu
Zëvendës Guvernator për Mbikëqyrje
të Institucioneve Financiare



Aneksi 1.

Personat Kontaktues

Në Maqedoni

Agjencisë për Mbikëqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional
Emri dhe mbiemri i personit kontakues : Pranvera Ajazi
Telefoni: +389 (0)2 3224 229 & +389 (0)75 240 912
Fax:+389 (0)2 3166 452
e-mail:pranvera.ajazi@mapas.gov.mk
Adresa:Leningradska 100, 1000 Shkup, RM

Në Kosovë

Banka Qendrore e Republikës së Kosoves
Emri dhe mbiemri i personit kontakues:Veton Zeqiraj
Telefoni:++381(0)38222055ext.320 Mob.++386 (0)49 740 105
Fax:++381(0) 38246879
e-mail: vetonzeqiraj@bqk-kos.org
Adresa: Garibaldi nr.33 10000 Prishtinë, Kosova